

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

TEKSTIL

Niveli II

**(Në drejtimin mësimor
TEKSTIL-KONFEKSIONE)**

Kodi: D2-II-11

Miratoi:

MINISTRI

Myqerem TAJAJ

Tiranë, 2011

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Tekstil”, niveli II, të drejtimit mësimor “Tekstil-Konfeksione”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Tekstil”, niveli II.**
 1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Tekstil”, niveli II
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Tekstil”, niveli II
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Tekstil”, niveli II
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Tekstil”, niveli II.
- III. Plani mësimor për profilin “Tekstil”, niveli II.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Tekstil”, niveli II,**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Tekstil”, niveli II, të drejtimit “Tekstil-Konfeksione”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Tekstil”, niveli II, të drejtimit “Tekstil-Konfeksione”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimet e materialeve të tekstilit.* Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Tekstil”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Tekstil”, niveli II

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Tekstil” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Tekstil-Konfeksione”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MASH përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Tekstil”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Tekstil”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Tekstil”, niveli II.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Tekstil”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të kryejë përzjerjen e fibrave;
- Të përdorë kartën teknologjike të makinës së agregatit;
- Të kontrollojë cilësinë e vellos së fibrave;
- Të realizojë vazhdueshmërinë e procesit në makinat e shtëllungës;
- Të kontrollojë parametrat teknologjikes të makinave të krehjes;
- Të eliminojë mbetjet teknologjike gjatë procesit të punës;
- Të realizojë prodhimin e fillit sipas numrave të përcaktuar;
- Të ndajë fillin ind nga ai bazë;
- Të kontrollojë aparatit e tërheqjes;
- Të sigurojë vazhdimësinë e punës në makinat e mbledhjes;
- Të mbushë kafazin e makinave së endjes sipas kartës teknologjike;
- Të kryejë regjistrimin e aparatit matës në makinën e endjes;
- Të sigurojë cilësinë e prodhimit në boshte;
- Të përgatisë solucionin e kollit për asortimentin e kërkuar;
- Të kontrollojë cilësinë e prodhimit të fillit të kollarisur;
- Të përzgjedhë numrin e krehrave për tekstilet që do prodhojë;
- Të vërë në punë makinat e tezgjahut;
- Të përdorë raportin e ngjyrave;



- Të eliminojë këputjet e fillit;
- Të sigurojë vazhdimësinë e punës në makinat e tezgjahut;
- Të realizojë tekstile me cilësi të mirë
- Të përgatisë fillin për ngjyrim;
- Të kryejë procesin e përcëllimit të pëlhurave;
- Të realizojë procesin e zierjes së fillit dhe pëlhurave;
- Të realizojë procesin e zbardhimit dhe tharjes së fillit dhe pëlhurave;
- Të kryejë ngjyrimin e fillit në bobina;
- Të realizojë ngjyrimin e fillit në litra;
- Të realizojë ngjyrimin e pëlhurave në nuancat e kërkuara;
- Të kryejë procesin e kalandrimit të pëlhurave;
- Të përgatisë solucionet e apretimit të pëlhurave;
- Të realizojë pretimin e pëlhurave;
- Të kryejë procesin e mermerizimit të pëlhurave;
- Të realizojë zgjerimin e pëlhurave sipas nevojave të linjës teknologjike;
- Të kryejë sanforizimin e tekstileve;
- Të realizojë stampimin e pëlhurave;
- Të shquajë lloje të ndryshme pëlhurash dhe të bëjë klasifikimin e tyre;
- Të realizojë amablazhimin dhe etiketimin e fillit dhe pëlhurave
- Të realizojë magazinimin dhe ruajtjen e fillit dhe pëlhurave sipas standardeve përkatëse
- Të vlerësojë cilësinë e fillit dhe të pëlhurave, si dhe ambalazhimin e etiketimin tyre;
- Të respektojë standardet e profesionit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit;
- Të përdorë në mënyrë të pavarur literaturat profesionale.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtjshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Tekstil”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Tekstil”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t'i drejtohet tregut të punës në industrinë tekstile si kombinate tekstili apo fabrika filature, fabrika tezgjahu, fabrika ngjyrimi filli apo beze; si dhe në mjaft reparte ndihmëse të industrisë tekstile.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (technik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar diplomën e “maturës profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Tekstil” niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Tekstil”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/10 (272/340)
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2
2		Gjuhë e huaj	2
3		Gjuhë e huaj 2 (opsionale)	(2)
4		Matematikë	2
5		Teknologji informimi e komunikimi	1
6		Aftësi për jetën	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-10-218-11	Filaturimi i fillit	2
3	L-10-219-11	Tezgjah	2
4	L-10-220-11	Përmbarimi dhe ngjyrimi i tekstileve	1
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-10-607-11	Krehja e fibrave tekstile	51
2	M-10-608-11	Prodhimi i fillit	51
3	M-10-609-11	Përgatitja e fillit për tezgjah	68
4	M-10-610-11	Prodhimi i tekstit në tezgjah	68
5	M-10-611-11	Përmbarimi i fillit dhe i pëlhurave	68
6	M-10-612-11	Ngjyrimi i fillit dhe i pëlhurave	102
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-10-613-11	Filaturimi i fibrave të leshit	51
2	M-10-614-11	Thurrjet e pulovrave	51
3	M-10-615-11	Përmbarimi dhe ngjyrimi i tekstileve sintetike	51
4	M-10-616-11	Prodhimi i tekstit oksford	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/32 (1020/ 1088)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 32 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Tekstil”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASH).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxëniet aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxëniet duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Tekstil”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathhtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxëniet nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Tekstil”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve

dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Tekstil”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e tekstilit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të niv. II.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Tekstil”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Tekstil”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësisë profesionale, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MASH, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore
- Të analizojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes
- Të shpjegojnë funksionet themelore të menaxhimit në biznes
- Të shpjegojnë se si funksionon tregu
- Të shpjegojnë veprimtaritë kryesore të bankave të niveleve të dyta
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut
- Të listojnë katër "P"-të e marketingut
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12 - 68 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Kërkimi sipërmarrës dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Menaxhimi dhe organizimi i punës në biznes	10 orë
Tema 5	Tregu	7 orë
Tema 6	Paraja, bankat dhe krediti	7 orë
Tema 7	Njohuri për marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	6 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	9 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	2 orë

2. Lënda “Filaturimi i fillit” (L-10-218-11). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Filaturimi i fillit”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Filaturimi i fillit”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojë rëndësinë e magazinimit të lëndës së parë
- Të listojë funksionet kryesore të proceseve në repartin e agregatit.
- Të shpjegojë rëndësinë e shkrifjes dhe përzierjes së fibrave tekstile.
- Të shpjegojë ndikimin e metodës së tjerjes në vetitë e fillit.



- Të analizojë cilësinë e shtëllungës së prodhuar.
- Të listojë funksionet kryesore të krehjes së fibrave tekstile.
- Të listojë ndryshimet që egzistojnë ndërmjet krehjes së zakonshme dhe krehjes së lartë.
- Të shpjegojë arsyet e kthimi të fjongos në fitil.
- Të shpjegojë rëndësinë e shumëfishimit të fillit
- Të shpjegojë rëndësinë e dredhjes së fillit.
- Të listojë vetitë fiziko-mekanike që fiton filli në fund të procesit të filaturimit.

• **Përmbajtjet e lëndës “Filaturimi i fillit”, kl. 12 – 68 orë**

Tema 1	Depo e lëndës së parë	6 orë
Tema 2	Shkrifja dhe përzierja e fibrave tekstile	12 orë
Tema 3	Krehja e zakonshme e fibrave tekstile	10 orë
Tema 4	Krehja e lartë e fibrave tekstile	12 orë
Tema 5	Prodhimi i fitilit të fibrave tekstile	6 orë
Tema 6	Tjerrja e fillit	8 orë
Tema 7	Shumëfishimi i fillit	6 orë
Tema 8	Dredhja e fillit	8 orë

3. Lënda “Tezgjah” (L-10-219-11). Kl. 12 – 68 orë

• **Synimet e lëndës “Tezgjah”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Tezgjah”, kl 12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojë rëndësinë dhe qëllimit e proceseve të prodhimit të tekstileve dhe trikotazhit.
- Të përshkruajë skemën teknologjike të fabrikës së tezgjahut
- Të kryejë mbushjen e kafazit të endjes
- Të përshkruajë procesin e mbledhjes së fillit në automat.
- Të kryejë përgatitjen e kollit
- Të shpjegojë mënyrën e përshkimit të fillit bazë sipas asortimenteve.
- Të përshkruajë mënyrën e thurrjes së fillit bazë dhe atij ind.
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të tekstilit
- Të analizojë rëndësinë e krehjes së tekstileve.
- Të listojë karakteristikat dhe kushtet që duhet të plotësojë filli për trikotazh
- Të përshkruajë operacionet përgatitore të fillit për thurje
- Të përshkruajë strukturën dhe procesin e formimit të syzave të trikotazhit
- Të klasifikojë makinat e prodhimit të trikotazhit
- Të tregojë karakteristikat e thurjeve kryesore të trikotazhit.
- Të listojë proceset e përpunimit të trikotazhit
- Të përshkruajë prodhimin e trikotazheve të gatshme
- Të shpjegojë ndikimin e ndërtimit të trikotazhit në vetitë dhe pamjen e tij.
- Të kontrollojë cilësinë e tekstileve dhe trikotazheve.
- Të kryejë etiketimin dhe ambalazhimin e tekstileve dhe trikotazhit sipas kushteve teknike.



• **Përmbajtjet e lëndës “Tezgjah”, kl. 12 – 68 orë**

Tema 1	Mbledhja e fillit bazë dhe ind	10 orë
Tema 2	Endja e fillit bazë	10 orë
Tema 3	Kollaritja e fillit bazë	6 orë
Tema 4	Përshkimi i boshteve të bazës	6 orë
Tema 5	Endja e fijeve bazë dhe ind në tezgjah	12 orë
Tema 6	Reparti i kontrollit	6 orë
Tema 7	Krehja e tekstileve	6 orë
Tema 8	Njohuri mbi trikotazhet	2 orë
Tema 9	Struktura e syzës së trikotazhit dhe prodhimi i tij	2 orë
Tema 10	Klasifikimi i thurjeve të thjeshta të trikotazhit dhe karakteristikat e tyre	3 orë
Tema 11	Përpunimi dhe vetitë e trikotazheve	3 orë
Tema 12	Prodhimi i trikotazheve të gatshme	2 orë

4. Lënda “Përmbardimi dhe ngjyrimi i nekstileve” (L-10-220-11). Kl. 12 – 34 orë

• **Synimet e lëndës “Përmbardimi dhe ngjyrimi i tekstileve”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Përmbardimi dhe ngjyrimi i tekstileve”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të klasifikojnë lloje të ndryshme të pëlhurave tekstile
- Të shpjegojnë rëndësinë dhe qëllimin e proceseve të përmbardimit;
- Të shpjegojnë llojet dhe rëndësinë e proceseve të ngjyritit të tekstileve;
- Të shpjegojnë vijueshmërinë e proceseve të përmbardimit dhe ngjyritit të tekstileve;
- Të analizojnë ndikimin e proceseve përgatitore në cilësinë e procesit të ngjyritit;
- Të shpjegojnë gjithë hallkat e procesit të përgatitjes për ngjyrim;
- Të shpjegojnë metodat e ngjyritit dhe ndryshimet mes tyre;
- Të përshkruajnë lloje të ndryshme operacionesh të përmbardimit të tekstileve;
- Të shpjegojnë metodat e stampimit dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajnë ndikimin e sanforizimit në cilësinë e tekstileve;
- Të shpjegojnë rëndësinë e kontrollit të cilësisë, ambalazhimit, etiketimit të produkteve të gatshme.

• **Përmbajtjet e lëndës “Përmbardimi dhe ngjyrimi i tekstileve”, kl. 12 – 34 orë**

Tema 1	Përgatitja dhe zbardhja e fillit për ngjyrim	2 orë
Tema 2	Ngjyrimi i fillit në turra dhe bobina	4 orë
Tema 3	Përcëllimi, zierja, zbardhja dhe tharja e tekstileve	4 orë
Tema 4	Ngjyrimi i tekstileve	10 orë
Tema 5	Apretimi dhe kalandrimi i tekstileve	3 orë
Tema 6	Zgjerimi dhe mercerizimi i tekstileve	2 orë
Tema 7	Termofiksimi dhe sanforizimi i tekstileve	3 orë
Tema 8	Stampimi i tekstileve	4 orë
Tema 9	Vlerësimi i cilësisë, ambalazhimi, etiketimi dhe magazinimi i tekstileve	2 orë



IX. Përshkruesit e moduleve të detyruar të praktikës profesionale

1. Moduli “Krehja e fibrave tekstile”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Tekstil

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	KREHJA E FIBRAVE TEKSTILE	M-10-607-11
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për depozitimim e fibrave tekstile në depo, zbatimin e kartave teknologjike të shkrifjes dhe përzierjes së fibrave tekstile, realizimin e produktit gjysëm të gatshëm, krehjen e fibrave tekstile.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi depoziton fibrat tekstile në depo. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit- Përgatitja e mjeteve të punës.- Veshja e uniformës së punës.- Realizimi i kushteve optimale në ambjentet e qendrimit të fibrave tekstile,- Shkarkimi i dengjeve me fibra tekstile.- Kontroll i parametrave shoqërues të fibrave teksile.- Sistemimi i dengjeve,.- Ndarja e dengjeve- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin e punës.- të përgatisë mjetet e punës.- të veshë uniformën e punës.- të realizojë kushtet optimale të punës sipas kartës	



teknologjike.

- të shkarkojë dengjet me fibrat tekstile.
- të kontrollojë parametrat shoqërues të fibrave tekstile.
- të sistemojë dengjet sipas përbërjes së fibrave tekstile.
- të ndajë dengjet me fibrat tekstile sipas kualiteteve
- të pastrojë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës.

RM 2 Nxënësi zbaton kartat teknologjike të shkrifjes dhe përzierjes së fibrave tekstile.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Interpretimi i kartave teknologjike të proceseve parapërgatitore;
- Përcaktimi i parametrave të nevojshëm për operacione të caktuar;
- Kontrolli i parametrave dhe gjendjes së pajisjeve/impianitit para fillimit të punës;
- Shkrifja e fibrave tekstile;
- Përzierja e fibrave tekstile;
- Pastrimi i fibrave tekstile;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të interpretojë kartat teknologjike të proceseve parapërgatitore;
- të përcaktojë parametrat e nevojshëm për operacione të caktuar, sipas kërkesave të kartës teknologjike;
- të kontrollojë parametrat dhe gjendjen e pajisjeve/impianitit para fillimit të punës;
- të realizojë shkrifjen e fibrave tekstile;
- të realizojë përzierjen e fibrave tekstile;
- të kryejë pastrimin e fibrave tekstile;
- të pastrojë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës.



RM 3 Nxënësi realizon produktin gjysëm të gatshëm (shtëllungën)

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Interpretimi i kartës teknologjike të materialit gjysëm të gatshëm;
- Përgatitja e parametrave të makinerisë së shtëllungës;
- Përcaktimi i drejtimit të fibrave tekstile;
- Përcaktimi i gjatësisë së shtëllungës;
- Përcaktimi i masës së shtëllungës;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të interpretojë kartën teknologjike të materialit gjysëm të gatshëm ;
- të përgatisë parametrat e makinerisë së shtëllungës;
- të kryejë drejtimin e fibrave tekstile;
- të realizojë gjatësinë e shtëllungës sipas kartës teknologjike;
- të përcaktojë masën e shtëllungës sipas parametrave të caktuar;
- të pastrojë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës.

RM 4 Nxënësi realizon krehjen e fibrave tekstile.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përcaktimi i parametrave të makinës së krehjes;
- Realizimi i ndarjes së tufave të fibrave në fibra të veçanta;
- Heqja e mëtejshme e papastërtive;
- Përzjerja e fibrave sipas drejtimit të tyre;
- Paralelizimi i fibrave;
- Realizimi i fjongove të fibrave;



- Realizimi i cilësisë së fjongove të fibrave
- Realizimi i barazisë së fibrave.
- Realizimi i shtrirjes së mirë të fibrave
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përcaktojë parametrat e makinës së krehjes
- të realizojë ndarjen e tufave të fibrave në fibra të veçanta;
- të kryejë heqjen e mëtejshme të papastërtive;
- të realizojë përzierjen e fibrave sipas drejtimit të tyre;
- të kryejë paralelizimin e fibrave;
- të realizojë fjongon e fibrave;
- të realizojë cilësinë e fjongove të fibrave sipas kushteve teknike
- të realizojë barazinë e fibrave.
- të realizojë shtrirjen e mirë të fibrave
- të pastrojë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës.

Udhëzime për zbatimin e modulit

-Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune të fabrikave të filaturimit, apo mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari.

-Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të teknikave të përdorimit të kartave teknologjike të linjave të caktuara dhe pajisjeve përkatëse.

-Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.

-Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.



Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, makineritë dhe materialet e mëposhtme:

- Fabrikë e filaturimit të fibrave tekstile ose mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari
 - Linjat e përpunimit paraprak dhe përfundimtar të fibrave të tekstilit;
 - Lëndët e para si fibrat e ndryshme tekstili;
 - Mjedise e magazina të ruajtjes në kushte optimale të fibrave tekstile
 - Karta teknologjike, manualë, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Prodhimi i fillit”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Tekstil

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PRODHIMI I FILLIT	M-10-608-11
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për prodhimin e shtullungës, zbatimin e kartës teknologjike për krehjen e fibrave tekstile, kthimin e fjongos në fitil, tjerren e fitilit dhe prodhimin e fillit të gatshëm në fabrikën e filaturës	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen proceset e prodhimit të shtullungës. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit të punës- Përgatitja e mjeteve të punës.- Veshja e uniformës së punës.- Interpretimi i kartës teknologjike të makinës së agregatit.- Rregjistrimi i parametrave të makinës së agregatit.- Përgatitja e makinerisë së agregatit, për shkrifjen dhe përzierjen e fibrave tekstile- Shkrifja e fibrave tekstile.- Përzierja e fibrave tekstile.- Kontrolli i drejtimit dhe paralelizimit të fibrave tekstile.- Heqja e papastërtive nga makina.- Prodhimi i shtëllungës.- Heqja e shtullungës nga makina e agregatit.- Kontrolli i parametrave të shtëllungës.- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin e punës.	

-
- të përgatisë mjetet e punës.
 - të veshë uniformën e punës.
 - të interpretojë saktë kartën teknologjike të makinerisë së agregatit.
 - të rregjistrojë parametrat e makinerisë së agregatit, sipas kartës teknologjike.
 - të përgatisë makinerinë e agregatit, për të realizuar shkrifjen dhe përzierjen e fibrave tekstile;
 - të shkrifë fibrat tekstile.
 - të përziejë fibrat tekstile.
 - të kontrollojë drejtimin dhe paralelizimin e fibrave tekstile, duke mbikqyrur cilësinë e vellos me fibra tekstile.
 - të eliminojë papastërtitë që lindin gjatë procesit të punës në makinë.
 - të prodhojë shtullungën, sipas parametrave teknologjikë.
 - të heqë shtëllungën nga makina e agregatit.
 - të kontrollojë parametrat e shtëllungës sipas kërkesave teknologjike.
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës për prodhimin e shtëllungës

RM 2 Nxënësi zbaton kartën teknologjike për krehjen e fibrave tekstile.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Interpretimi i kartave teknologjike të proceseve parapërgatitore;
- Përcaktimi i mënyrës së krehjes së fibrave
- Përgatitja e makinës së krehjes;
- Vendosja e parametrave në makineri.
- Kontrolli i vazhdimësisë së procesit të krehjes.
- Kontrolli i cilësisë së fjongos së prodhuar.
- Bashkimi i fjongove në aparatet bashkuese.
- Tërheqja e fjongos në aparatet tërheqës.
- Kontrolli i cilësisë së fjongos.
- Ribashkimi i fjongove.
- Tërheqja përfundimtare e fjongove.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:



- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të interpretojë kartat teknologjike të proceseve parapërgatitore;
- të përcaktojë mënyrën e krehjes së fibrave sipas cilësisë së tyre;
- të përgatisë makinën për krehjen e fibrave tekstile;
- të vendosë parametrat në makineri sipas kartës teknologjike.
- të kontrollojë vazhdimësinë e procesit të pandërprerë në makinën e krehjes.
- të kontrollojë cilësinë e fjongos së prodhuar sipas kërkesave teknologjike;
- të bashkojë fjongot në aparatet bashkuese, sipas kërkesave të fillit që prodhohet;
- të tërheqë fjongon lehtësisht nga aparati tërheqës;
- të kontrollojë cilësinë e fjongos së marrë nga aparati tërheqës.
- të ribashkojë fjongot;
- të realizojë tërheqjen përfundimtare të fjongove në makinat e tërheqjes;
- të pastrojë vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës.

RM 3 Nxënësi kryen procesin e kthimit të fjongos në fitil.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Interpretimi i kartës teknologjike për prodhimin e fitilit
- Vendosja e parametrave në makinën e fitilit
- Furnizimi i makinës së fitilit me fjongo,
- Kontrolli i procesit të hollimit të fjongos;
- Rregjistrimi i makinës për dredhje të lehtë të fjongos;
- Furnizimi i makinës së fitilit me çikrike;
- Realizimi i vazhdimësisë së punës në makinën e fitilit;
- Kontrolli i cilësisë së fitilit të prodhuar;
- Heqja e çikrikëve të mbushur me fitil;
- Vendosja e çikrikeve bosh në makinën e fitilit;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të



mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshe uniformen e punës.
- të interpretojë saktë kartën teknologjike për prodhimin e fitilit
- të vendosë parametrat në makinën e fitilit sipas kartës teknologjike;
- të furnizojë makinën e fitilit me fjongo;
- të kontrollojë procesin e hollimit të fjongos, sipas parametrave teknologjik;
- të regjistrojë makinën në parametrat e duhur, për dredhje të lehtë të fjongos;
- të furnizojë makinën e fitilit me çikrikë.
- të realizojë vazhdimësinë e pandërprerë të punës në makinën e fitilit;
- të kontrollojë cilësinë e fitilit të prodhuar sipas kartës teknologjike;
- të heqë çikrikët e mbushur me fitil;
- të vendosë çikrikët bosh në makinën e fitilit;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës.

RM 4 Nxënësi realizon procesin e tjerrjes së fitilit.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përcaktimi i parametrave të makinës së tjerrjes së fitilit;
- Regjistrimi i makinerisë së tjerrjes së fitilit;
- Furnizimi i makinerisë me fitil;
- Vendosja e masurave në makinën e fitilit,
- Kontrolli i cilësisë së tjerrjes së fitilit;
- Sigurimi i vashdimësisë së procesit të punës;
- Heqja e masurave të mbushur me fill;
- Shumëfishimi i fillit njësh,
- Dredhja e fillit të shumëfishuar;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:



- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përcaktojë parametrat e makinës së tjerrjes së fitilit, sipas kërkesave të fillit të kërkuar nga tregu;
- të regjistrojë makinerinë e tjerrjes së fillit;
- të furnizojë makinerinë me fitil, duke siguruar vashdimësinë e punës në të;
- të vendosë masurat në makinën e fitilit,
- të kontrollojë cilësinë e tjerrjes së fitilit, sipas parametrave të kërkuar;
- të sigurojë vashdimësinë e procesit të punës, duke kontrolluar cilësinë e fitilit;
- të heqë masurat e mbushur me fillin e prodhuar;
- të shumëfishojë fillin njësh sipas kërkesave të prodhimit,
- të dredhë fillin e shumëfishuar, sipas kërkesave teknologjike të prodhimit;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune të fabrikave të filaturimit, apo mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të teknikave të përdorimit të kartave teknologjike të linjave të caktuara dhe pajisjeve përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.



**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, makineritë dhe materialet e mëposhtme:

- Fabrikë e filaturimit të fibrave tekstile ose mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari.
 - Linjat e përpunimit paraprak dhe përfundimtar të fibrave të tekstilit;
 - Lëndët e para si fibra të ndryshme tekstili;
 - Karta teknologjike, manualë, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Përgatitja e fillit për tezgjah”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Tekstil

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PËRGATITJA E FILLIT PËR TEZGJAH	M-10-609-11
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të realizuar ngjyrim e fillit bazë dhe ind, mbledhjen e fillit bazë dhe endjen e fillit bazë në repartin e tezgjahut.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen ngjyrim e fillit bazë dhe ind. <i>Përmbajtja:</i> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit të punës- Përgatitja e mjeteve të punës.- Veshja e uniformës së punës.- Interpretimi i kartave teknologjike të ngjyrimit të fillit baze dhe ind;- Përzgjedhja e ngjyruësve kimik- Përcaktimi i raportit të ngjyruësve që do të përdoren;- Përzgjedhja e substancave kimike ndihmëse.- Përzgjedhja e zbutësve të ngjyrimit;- Përzjerja e ngjyruësve;- Hedhja e ngjyruësve në makineritë e ngjyrimit;- Vendosja e fillit në makinat e ngjyrimit;- Ngjyrimi i fillit në makineri;- Kontrolli i parametrave teknologjikë të makinave të ngjyrimit- Kontrolli i cilësisë së fillit të ngjyrosur;- Transportimi i fillit,- Tharja e fillit;- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	



Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të interpretojë kartat teknologjike të ngjyrimit të fillit bazë dhe ind;
- të përzgjedhë ngjyruerit kimike, sipas kartës teknologjike.
- të përcaktojë raportin e ngjyruerit në varësi të sasisë së fillit që do të ngjyroset;
- të përzgjedhë substancat kimike ndihmëse për ngjyruerit bazik dhe acid;
- të përzgjedhë, sipas kartës teknologjike, zbutësit që ndihmojnë në ngjyrim;
- të përziejë ngjyruerit;
- të hedhë ngjyruerit në makinat e ngjyrimit;
- të vendosë fillin në makinat e ngjyrimit;
- të ngjyrosë fillin në makineri, në varësi të kohës së ngjyrimit;
- të kontrollojë parametrat teknologjikë të makinave të ngjyrimit
- të kontrollojë cilësinë e fillit të ngjyrosur, sipas kriterëve të kartës teknologjike;
- të transportojë fillin në makinat e tharjes;
- të thajë fillin në makinat tharëse.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për ngjyrimin e fillit bazë dhe ind.

RM 2 Nxënësi kryen mbledhjen e fillit bazë.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse
- Transportimi i fillit në repartin e mbledhjes
- Interpretimi i kartës teknologjike të mbledhjes së fillit bazë;
- Vendosja e parametrave të makinës.
- Regjistrimi i makinës;
- Kontrolli i tërheqjes së fillit në aparatit përkatës;
- Mbledhja e fillit në bobina;
- Kontrolli i cilësisë së fillit të mbledhur;
- Eleminimi i mbetjeve teknologjike;



- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për mbledhjen e fillit bazë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme
- të transportojë fillin me karroca, në repartin e mbledhjes
- të interpretojë kartën teknologjike të mbledhjes së fillit bazë;
- të vendosë parametrat e makinës sipas fillit të kërkuar;
- të regjistrojë makinën sipas kartës teknologjike;
- të kontrollojë tërheqjen e fillit në aparatit tërheqës;
- të mbledhë fillin në bobina;
- të kontrollojë cilësinë e fillit të prodhuar;
- të eliminojë mbetjet teknologjike, duke i'u përmabajtur kartës teknologjike;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për mbledhjen e fillit bazë.

RM3 Nxënësi kryen endjen e fillit bazë.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse
- Transportimi i fillit në repartin e endjes
- Interpretimi i kartës teknologjike të endjes së fillit bazë;
- Llogaritja e sasisë së nevojshme të fijeve bazë;
- Ndarja e fijeve bazë.
- Mbushja e kafazit të makinës së endjes;
- Përshkimi i fijeve në aparatit tërheqës;
- Ndarja e fijeve bazë në bosht;
- Endja e fijeve bazë në bosht;
- Kontrolli i gjerësisë së boshtit,
- Regjistrimi i gjatësisë së fijeve;
- Mbushja e boshtit të tezgjahut;
- Përcaktimi i sasisë së kuadrateve me lisa;
- Përshkimi i fijeve bazë në lisa;
- Përcaktimi i numërit të krehërit;



- Përshkimi i fijeve bazë në krehër;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme
- të transportojë fillin në repartin e endjes
- të interpretojë saktë kartën teknologjike për endjen e fillit bazë;
- të llogarisë sasinë e nevojshme të fijeve bazë, sipas kartës teknologjike;
- të ndajë fijet bazë në bosht, sipas raportit të ngjyrave;
- të mbushë kafazin e makinës së endjes me bobina, sipas kartës teknologjike;
- të përshkojë fijet në aparatit tërheqës deri në boshtin e endjes;
- të ndajë fijet bazë në bosht sipas raportit të thurrjes;
- të endë fijet bazë në bosht sipas kartës teknologjike;
- të kontrollojë gjerësinë e nevojshme të fijeve bazë në bosht,
- të regjistrojë gjatësinë e kërkuar të fijeve në bosht, sipas kartës teknologjike;
- të mbushë boshtin me fill, sipas gjatësisë së regjistruar në makinë;
- të përcaktojë sasinë e kuadrateve me lisa në bazë të kartës teknologjike;
- të përshkojë fijet në lisa, sipas raportit të thurrjes;
- të përcaktojë numërin e krehërit, sipas kartës teknologjike;
- të përshkojë fijet bazë në krehër sipas kartës teknologjike;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për mbledhjen e fillit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune në repartet e ngjyrimit, mbledhjes dhe endjes, apo në ambiente të tjera të reparteve tekstile.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të teknikave të përdorimit të kartave teknologjike të linjave e metodave të ngjyrimit të



	<p>mbledhjes, të endjes dhe pajisjeve/impianeteve përkatëse.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë. - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, makineritë/impiantet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Reparte të ngjyrimit, mbledhjes, dhe endjes së fillit ose mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari; - Linjat e ngjyrimit, mbledhjes dhe endjes së fillit; - Lëndët e para si filli; - Ngjyruerit e nevojshëm për realizimin e ngjyrave të kërkuara; - Lëndët e para dhe ndihmëse për realizimin e proceseve të ndryshme të përpunimit; - Mjediset e magazinimit dhe ruajtjes në kushte optimale të produkteve përfundimtare; - Karta teknologjike, manualë, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Prodhimi i tekstilit në tezgjah”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Tekstil

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PRODHIMI I TEKSTILIT NE TEZGJAH	M-10-610-11
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të realizuar procesin e thurrjes së pëlhurës në makinën e tezgjahut, si dhe kontrollin e cilësisë së tekstilit të prodhuar në tezgjah.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen proceset parapërgatitore të nevojshme për prodhimin e tekstilit ne tezgjah. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit të punës- Përgatitja e mjeteve të punës.- Veshja e uniformës së punës.- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse- Interpretimi i kartave teknologjike të proceseve përgatitore për prodhimin e tekstilit në tezgjah;- Transportimi i boshteve me fillin bazë në tezgjah;- Vendosja e boshtit në makinën e tezgjahut;- Shtrirja e fijeve bazë.- Tërheqja e fijeve bazë.- Përcaktimi i sasisë së ngrave të fillit ind- Mbushja e tavolinës me fill ind;- Vendosja e masurave në zovajkë.- Formimi i gojës së fillit bazë;- Vendosja e parametrave të makinës së tezgjahut,- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin e punës.	



-
- të përgatisë mjetet e punës.
 - të veshë uniformën e punës.
 - të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme
 - të interpretojë kartën teknologjike të proceseve përgatitore për prodhimin e tekstit në tezgjah;
 - të transportojë boshtet me fillin bazë në tezgjah nga reparti i endjes;
 - të vendosë boshtin me fill bazë në makinën e tezgjahut;
 - të shtrijë fijet bazë mbi trupin e makinës së tezgjahut;
 - të terheqë me kujdes fijet bazë mbi makinën e tezgjahut;
 - të përcaktojë sasinë e ngyrave të fillit ind, sipas kartës teknologjike,
 - të mbushë tavolinën me fill ind;
 - të vendosë masurat në zovajkë, sipas radhës së kartës teknologjike;
 - të formojë gojën e fillit bazë;
 - të vendosë parametrat e makinës së tezgjahut sipas kartës teknologjike,
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës për prodhimin e tekstit në tezgjah.

RM 2 Nxënësi realizon thurrjen e pëlhurës në makinën e tezgjahut

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Vendosja e raportit të ngjyrave.
- Kontrolli i cilësisë së fijeve bazë.
- Vënia në punë e makinës.
- Kontrolli i raportit të ngjyrave.
- Kontrolli i cilësisë së përlhurës.
- Eleminimi i këputjeve të fillit bazë.
- Eleminimi i këputjeve të fillit ind.
- Rivendosja e raportit të ngjyrave.
- Mbledhja e pëlhurës në bosht.
- Prerja e pëlhurës.
- Heqja e boshtit.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.



Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme
- të vendosë raportin e saktë të ngjyrave, sipas llojit të thurrjes.
- të kontrollojë cilësinë e fijeve bazë në mënyrë mekanike.
- të vërë në punë makinën, duke shtypur butonin e ndezjes se saj.
- të kontrollojë saktësinë e raportit të ngjyrave, sipas kartës teknologjike.
- të kontrollojë cilësinë e pëlhurës së prodhuar, sipas parametrave të kërkuar;
- të eliminojë në kohë të shkurtër këputjen e fijeve bazë.
- të eliminojë këputjet e fillit ind.
- të rivendosë raportin e ngjyrave në vashdimësi të këputjes së fijeve.
- të mbledhë me kujdes pëlhurën në bosht, duke përdorur aparatet tërheqëse.
- të presë pëlhurën në boshtin e mbushur me të, sipas parametrave të caktuar të gjatësisë;
- të heqë boshtin e mbushur me pëlhurë nga makina e tezgjahut
- Pastrimi i vendit të punës, duke respektuar rregullat higjieno sanitare;
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës për thurrjen e pëlhurës në makinën e tezgjahut.

RM 3 Nxënësi kontrollon cilësinë e pëlhurës së prodhuar

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Vendosja e boshtit me pëlhurë në këmbalec.
- Kalimi i pëlhurës në ekranet pastruese.
- Pastrimi i pëlhurës nga papastërtitë.
- Vendosja e pëlhurës në tavolinat mbajtëse.
- Kalimi i pëlhurës në makinat matëse palosëse.
- Kontrolli i sasisë totale të pëlhurës.
- Kontrolli i cilësisë së pëlhurës së prodhuar.
- Vendosja e etiketës në topin e pëlhurës së prodhuar
- Pastrimi i vendit të punës.



- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme
- të vendosë boshtin me pëlhurë në këmbalec.
- të kalojë pëlhurën në ekranet pastruese.
- të pastrojë pëlhurën nga papastërtitë.
- të vendosë pëlhurën në tavolinat mbajtëse.
- të kalojë pëlhurën në makinat matëse palosëse sipas kartës teknologjike, duke eleminuar perikosin.
- të kontrollojë sasinë totale të pëlhurës, duke e matur atë;
- të kontrollojë cilësinë e pëlhurës sipas kartës teknologjike.
- të vendosë etiketën me të dhenat perkatëse në topin e pëlhurës së prodhuar;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për kontrollin e cilësisë së pëlhurës së prodhuar.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune të repartit të tezgjahut .
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të teknikave të vlerësimit të cilësisë së produkteve të pëlhurave të prodhuara dhe pajisjeve perkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.



Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, makineritë/impiantet dhe materialet e mëposhtme:

- Reparti i tezgjahut për prodhimin e pëlhurave;
 - Linjat e kontrollit të pëlhurave;
 - Lëndët e para si filli bazë dhe ind;
 - Kartat teknologjike për prodhimin e pëlhurave;
 - Lëndët e para dhe ndihmëse për realizimin e proceseve të përfundimit të kontrollit të pëlhurave;
 - Mjediset e magazinimit dhe ruajtjes në kushte optimale të produkteve përfundimtare;
 - Karta teknologjike, manualë, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

5. Moduli “Përmbarimi i fillit dhe i pëlhurave”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Tekstil

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PËRMBARIMI I FILLIT DHE I PËLHURAVE	M-10-611-11
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të përgatitur fillin dhe pëlhurat për ngjyrim si dhe ambalazhimin e tyre për industrinë e konfeksioneve dhe tregun.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zbaton kartat teknologjike të përcëllimit, zierjes, zbardhjes dhe tharjes së fillit/pëlhurave. <i>Përmbajtja:</i> <ul style="list-style-type: none">- Inerpretimi i kartave teknologjike të proceseve parapërgatitore;- Përgatitja e solucioneve të nevojshme për proceset parapërgatitore;- Përcaktimi i parametrave të nevojshëm për operacione të caktuar;- Kontrolli i parametrave dhe gjendjes së pajisjeve/impianitit para fillimit të punës;- Përcëllimi i bezes në përputhje me kartën teknologjike;- Zierja e fillit/bezes duke respektuar parametrat e përcaktuar më parë;- Zbardhja e fillit/pëlhurave- Tharja e fillit/pëlhurave- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të interpretojë kartat teknologjike të proceseve parapërgatitore;	



-
- të përgatis solucionet e nevojshme për proceset parapërgatitore në varësi të llojit të tekstilit;
 - të përcaktojë parametrat e nevojshëm për operacione të caktuar, sipas kërkesave të kartës teknologjike;
 - të kontrollojë parametrat dhe gjendjen e pajisjeve/impianitit para fillimit të punës;
 - të realizojë përcëllimin e bezes në përputhje me kartën teknologjike ;
 - të realizojë zierjen e fillit/ pëlhurave, duke respektuar parametrat e përcaktuar më parë;
 - të kryejë zbardhjen e fillit/pëlhurave sipas kërkesave të operacioneve të linjës teknologjike në vazhdim;
 - të realizojë tharjen e fillit/pëlhurave në varësi të destinacionit të produktit;
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës për zbatimin e kartave teknologjike të përcëllimit, zierjes, zbardhjes dhe tharjes së fillit/pëlhurave.

RM 2 Nxënësi realizon procesin e apretimit, kalandrimit, zgjerimit dhe mercerizimit të tekstileve.

Përmbajtja:

- Interpretimi i kartës teknologjike të linjës së apretimit;
- Përgatitja e solucioneve të apretimit;
- Apretimi i tekstileve
- Përcaktimi i parametrave të makinës së kalandrimit;
- Kalandrimi i tekstileve
- Zgjerimi i tekstileve;
- Interpretimi i kartës teknologjike të mermerizimit;
- Mermerizimi i tekstileve;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të interpretojë kartën teknologjike të linjës së apretimit ;
- të përgatis solucionet e apretimit në varësi të tekstilit që do të përpunohet;
- të kryej apretimin e tekstileve; sipas llojit të pëlhurës dhe në përputhje me kartës teknologjike
- të përcaktojë parametrat e makinës së e kalandrimit;
- të kryejë kalandrimin e tekstileve, sipas llojit të pëlhurës

- dhe në përputhje me kartës teknologjike;
- të zgjerojë tekstilet në përmasat e kërkuara
- të interpretojë kartën teknologjike të mermerizimit;
- të mermerizojë tekstilet sipas standardeve të përcaktuara;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës.

RM 3 Nxënësi realizon termofiksimin dhe sanforizimin e tekstileve

Përmbajtja:

- Përcaktimi i parametrave të termofiksimit.
- Përgatitja e solucioneve për termofiksimit.
- Termofiksimit i tekstileve të ndryshme.
- Kryerja e provës së cilësisë së termofiksimit;
- Sanforizimi i llojeve të ndryshme të pëlhurave;
- Përcaktimi i parametrave të sanforizimit;
- Sanforizimi i tekstileve të ndryshme
- Kontrolli i cilësisë së sanforizimit.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë parametrave e termofiksimit për një tekstil të caktuar;
 - të përgatisë solucionet për termofiksimit sipas kartës teknologjike;
 - të kryej termofiksimit e tekstileve të ndryshme sipas kartës teknologjike;
 - të kryejë provën e cilësisë së termofiksimit;
 - të sanforizojë lloje të ndryshme pëlhurash
 - të përcaktojë parametrat e sanforizimit sipas llojit të tekstilit;
 - të realizojë sanforizimin e tekstileve të ndryshme sipas kartës teknologjike;
 - të kryejë provën e kontrollit të cilësisë së sanforizimit;
 - të pastrojë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës.



RM 4 Nxënësi realizon stampimin, kontrollin e cilësisë, ambalazhimin dhe etiketimin e tekstileve.

Përmbajtja:

- Përzgjedhja e metodës së stampimit;
- Stampimi i pëlhurave;
- Kontrolli i cilësisë së stampimit;
- Vlerësimi i cilësisë së pëlhurave të stampuara;
- Ambalazhimi i pëlhurave;
- Etiketimi i pëlhurave;
- Magazinimi i produkteve të gatshme në kushte optimale.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë metodën e stampimit, në varësi të llojit të tekstit ;
- të stampojë pëlhurat; ndinje indikator konkret se si stampohet
- të kontrollojë cilësinë e stampimit;
- të vlerësojë cilësinë e pëlhurave duke i klasifikuar sipas standardeve të cilësisë;
- të ambalazhojë pëlhurat;
- të etiketojë pëlhurat sipas treguesve fizikë e cilësorë;
- të magazinojë pëlhurat, duke i ruajtur ato në kushte optimale;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune të fabrikave të ngjyimit, apo mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të teknikave të përdorimit të kartave teknologjike të linjave të caktuara dhe pajisjeve përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e



detyrave të dhëna.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, makineritë dhe materialet e mëposhtme:

- Fabrikë ngjyrimi e fillit dhe pëlhurave ose mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari
 - Linjat e përpunimit paraprak dhe përfundimtar të fillit dhe pëlhurave;
 - Lëndët e para si filli dhe pëlhura të ndryshme;
 - Lëndët e para dhe ndihmëse për realizimin e proceseve të ndryshme të përmbarimit;
 - Mjediset e magazinimit dhe ruajtjes në kushte optimale të produkteve përfundimtare
 - Karta teknologjike, manualë, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-



6. Moduli “Ngjyrimi i fillit dhe i pëlhurave”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Tekstil

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	NGJYRIM I FILLIT DHE I PËLHURAVE	M-10-612-11
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të realizuar procesin e ngjyimit të fillit dhe pëlhurave, sipas kërkesave të industrisë së konfeksioneve dhe tregut.	
Kohëzgjatja e modulit	102 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi ngjyros fillin në turra <i>Përmbajtja:</i> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit të punës.- Përgatitja e pajisjeve dhe mjeteve të punës.- Veshja e uniformës së punës.- Interpretimi i kartës teknologjike të ngjyimit të fillit në turra;- Përcaktimi i parametrave të nevojshëm për ngjyrimin e fillit në turra.- Kontrolli i parametrave dhe gjendjes së pajisjeve/impianitit të ngjyimit- Përgatitja e turrave për ngjyrim;- Ngjyrimi i fillit në turra.- Kryerja e kontrollit të cilësisë së ngjyimit- Tharja e fillit të ngjyrosur.- Vlerësimi i cilësisë së fillit të ngjyrosur- Ambalazhimi i fillit të ngjyrosur- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin e punës.	



-
- të përgatisë pajisjet dhe mjetet e punës.
 - të veshë uniformën e punës;
 - të interpretojë kartën teknologjike të ngjyrimin të fillit në turra;
 - të përcaktojë parametrat e nevojshëm për ngjyrimin e fillit në turra.
 - të kontrollojë parametrat dhe gjendjen e pajisjeve/impianitit të ngjyrimin
 - të përgatisë turrat për ngjyrim, duke i vendosur turrat në boshtet përkatëse të pajisjes së ngjyrimin;
 - të ngjyrosë fillin në turra
 - të kontrollojë cilësinë e ngjyrimin gjatë procesit, sipas standardeve përkatëse;
 - të thajë fillin e ngjyrosur;
 - të vlerësojë cilësinë e fillit të ngjyrosur, sipas kartës teknologjike;
 - të ambalazhojë fillin e ngjyrosur
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për ngjyrimin e fillit në turra.

RM 2 Nxënësi ngjyros fillin në bobina.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e pajisjeve dhe mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Interpretimi i kartës teknologjike të ngjyrimin të fillit në bobina;
- Përcaktimi i parametrave të nevojshëm për ngjyrimin e fillit në bobina.
- Kontrolli i parametrave dhe gjendjes së pajisjeve/impianitit të ngjyrimin të fillit në bobina.
- Përgatitja e bobinave për ngjyrim;
- Ngjyrimi i fillit në bobina.
- Kryerja e kontrollit të cilësisë së ngjyrimin.
- Tharja e fillit të ngjyrosur.
- Vlerësimi i cilësisë së fillit të ngjyrosur
- Ambalazhimi i fillit të ngjyrosur
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:



- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë pajisjet dhe mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës;
- të interpretojë kartën teknologjike të ngjyrimit të fillit në bobina;
- të përcaktojë parametrat e nevojshëm për ngjyrimin e fillit në bobina.
- të kontrollojë parametrat dhe gjendjen e pajisjeve/impianitit të ngjyrimit
- të përgatisë bobinat për ngjyrim, duke i vendosur bobinat në boshtet përkatëse të pajisjes së ngjyrimit;
- të ngjyrosë fillin në bobina
- të kontrollojë cilësinë e ngjyrimit gjatë procesit, sipas standardeve përkatëse;
- të thajë fillin e ngjyrosur;
- të vlerësojë cilësinë e fillit të ngjyrosur, sipas kartës teknologjike;
- të ambalazhojë fillin e ngjyrosur;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për ngjyrimin e fillit në bobina.

RM 3 Nxënësi përgatit pëlhurat për ngjyrim

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e pajisjeve dhe mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e pëlhurave për ngjyrim.
- Përzgjedhja e proceseve të përpunimit parapërgatitor për ngjyrim.
- Përcëllimi i pëlhurave.
- Zierja e pëlhurave
- Zbardhimi i pëlhurave.
- Tharja e pëlhurave
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë pajisjet dhe mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës;
- të përzgjedhë pëlhurat për ngjyrim.



- të përzgjedhë proceset e përpunimit parapërgatitor për ngjyrim, në varësi të përbërjes dhe destinacionit të pëlhurës;
- të përcëllojë pëlhurat, sipas kartave teknologjike
- të ziejë pëlhurat, në varësi të llojit të pëlhurës;
- të zbardhojë pëlhurat, sipas kartës teknologjike;
- të thajë pëlhurat, sipas kërkesave të linjës teknologjike në vijim;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për përgatitjen e pëlhurave për ngjyrim.

RM 4 Nxënësi ngjyros pëlhurat.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e pajisjeve dhe mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e metodës së ngjyrimit.
- Përgatitja e solucioneve të ngjyrimit;
- Përcaktimi e parametrave të makinës/impianitit të ngjyrimit;
- Ngjyrimi i pëlhurave;
- Kontrolli i vijueshmërisë së procesit të ngjyrimit;
- Kontrolli i cilësisë së ngjyrimit të pëlhurave;
- Larja e e pëlhurave pas ngjyrimit;
- Tharja e pëlhurave pas ngjyrimit;
- Analiza e treguesve teknikë të ngjyrës;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të Përgatisë pajisjet dhe mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përzgjedhë metodën e ngjyrimit, në varësi të llojit dhe destinacionit të pëlhurës;
- të përgatisë solucionet e ngjyrimit, në varësi të llojit të pëlhurës;
- të përcaktojë parametrat e makinës/impianitit të ngjyrimit, në varësi të llojit të pëlhurës;;
- të ngjyrosë pëlhurat;



- të kontrollojë vijueshmërinë e procesit të ngjyritit;
- të kontrollojë cilësinë e ngjyritit të pëlhurave, sipas standardeve të parametrave të ngjyritit;
- të lajë pëlhurat pas ngjyritit, sipas kërkesave të kartës teknologjike;
- të thajë pëlhurat pas ngjyritit;
- të analizojë treguesit teknikë të ngjyrës së pëlhurës së ngjyrosur;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për ngjyrimin e pëlhurave.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune të fabrikave të ngjyritit, apo mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të teknikave të përdorimit të kartave teknologjike të linjave e metodave të ngjyritit dhe pajisjeve/impianteve përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, makineritë/impianetet dhe materialet e mëposhtme:
- Fabrikë ngjyrimi e fillit dhe e pëlhurave ose mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari;
 - Linjat e ngjyritit të fillit dhe pëlhurave;
 - Lëndët e para si filli dhe pëlhura;
 - Ngjyruesit e nevojshëm për realizimin e ngjyrave të kërkuara;
 - Lëndët e para dhe ndihmëse për realizimin e proceseve të ndryshme të përpunimit;
 - Mjediset e magazinimit dhe ruajtjes në kushte optimale të produkteve përfundimtare;
 - Karta teknologjike, manualë, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-



X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Filaturimi i fibrave të leshit”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Tekstil

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	FILATURIMI I FIBRAVE TË LESHIT	M-10-613-11
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të realizuar proceset e përzierjes së fibrave të leshit, krehjes dhe përgatitjes së fitilit, për përgatitjen e fillit të leshit në repartet e filaturimit të leshit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit lëndën e parë për përzierjen e fibrave të leshit. <i>Përmbajtja:</i> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit të punës.- Përgatitja e mjeteve të punës.- Veshja e uniformës së punës.- Interpretimi i kartave teknologjike- Asortimi (ndarja) i fibrave të leshit;- Shkrifja e fibrave të leshit;- Përgatitja e vaskave larëse;- Përgatitja e solucioneve larëse;- Shtydhja e fibrave të leshit;- Shpëlarja e fibrave të leshit- Tharja e fibrave të leshit;- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:	



-
- të përgatisë vendin e punës.
 - të përgatisë mjetet e punës.
 - të veshë uniformën e punës.
 - të interpretojë kartën teknologjike të përgatitjes së lëndës së parë, për përzjerjen e fibrave të leshit;
 - të asortojë (ndajë) fibrat e leshit, sipas cilësisë së tyre;
 - të shkrifë fibrat e leshit, duke i ndarë nga njëra tjetra;
 - të përgatisë vaskat larëse, duke i mbushur me ujë të ngrohtë, me temperaturë të caktuar ngrohjeje;
 - të përgatise solucionet larëse për fibrat e leshit, si sapunet etj.
 - të shtrydhë mirë fibrat e leshit;
 - të shpëlajë fibrat e leshit në vaska shpëlarëse;
 - të thajë fibrat e leshit në temperaturat e caktuara
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për përgatitjen e lëndës së parë për përzjerjen e fibrave të leshit.

RM 2 Nxënësi përgatit përzjerjen e fibrave të leshit.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse
- Interpretimi i kartës teknologjike të përzjerjes së fibrave të leshit;
- Shkrifja e fibrave të leshit;
- Përzjerja e fibrave të leshit;
- Rrahja e fibrave të leshit;
- Kontrolli i cilësisë së materialit të përzier;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme për përzjerjen e fibrave të leshit.
- të interpretojë kartën teknologjike të përzjerjes së fibrave të leshita;



- të shkrifë fibrat e leshit në makinat shkrifëse;
- të përziejë fibrat e leshit;
- të rrahë fibrat e leshit në makineritë rahëse;
- të kontrollojë cilësinë e materialit të përzierë (Vello)
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për mbledhjen e fillit.

RM3 Nxënësi kryen krehjen dhe përgatitjen e fitilit të marrë nga fibrat e leshit.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të nevojshme
- Interpretimi i kartës teknologjike të krehjes së fibrave të leshit; (apo te përgatitjes së fitilit?)
- Vendosja e parametrave teknologjikë në makinën e krehjes;
- Furnizimi i makinës së krehjes me vellon e fibrave të leshit;
- Krehja e fibrave të leshit;
- Kontrolli i cilësisë së krehjes;
- Heqja e fjongos nga makina e krehjes;
- Kontrolli i barazisë së fjongos;
- Kalimi i fjongos në makinerinë e krehjes së lartë;
- Kontrolli i drejtimit të fibrave;
- Kontrolli i paralelizimit të fibrave;
- Heqja e fjongos nga makinat e krehjes së lartë,
- Furnizimi me fjongo i makinës së fitilit;
- Dredhja e fitilit;
- Mbushja e cikrikëve.
- Heqja e cikrikëve të mbushur.
- Tjerrja e fitilit.
- Mbushja e masurat me fill të tjerrur;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.



- të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme
- të interpretojë kartën teknologjike për krehjen e fibrave të leshit dhe përgatitjes së fitilit;
- të vendosë parametrat teknologjikë në makinën e krehjes;
- të furnizojë makinën e krehjes me vellon e fibrave të leshit;
- të krehë fibrat e leshit në makinat krehëse;
- të kontrollojë cilësinë e materialit të krehur, duke vëzhguar paralelizimin e fibrave;
- të heqë fjongon nga makina e krehjes;
- të kontrollojë barazinë e fjongos, sipas kërkesave të kartës teknologjike;
- të furnizojë me fjongo makinën e krehjes së lartë;
- të kontrollojë drejtimin e fibrave të leshit në vellon e prodhuar në makinën e krehjes së lartë;
- të kontrollojë paralelizimin e fibrave të leshit në vello;
- të heqë fjongot nga makinat e krehjes së lartë;
- të furnizojë makinën e fitilit me fjongo;
- të realizojë dredhejn e fitilit në makinën e dredhjes, sipas kërkesave të kartës teknologjike;
- të mbushë cikrikët me fitil të dredhur;
- të heqë cikrikët e mbushur me fitil të dredhur, nga makina dredhjes;
- të tjerë fitilin, sipas kërkesave të kartës teknologjike;
- të mbushë masurat me fill të tjerrur;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për krehjen dhe përgatitjen e fitilit të marrë nga fibrat e leshit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune në repartet e sistemit të krehjes dhe tjerrjes së fibrave të leshit, apo në ambiente të tjera të reparteve tekstile.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të teknikave të përdorimit të kartave teknologjike të linjave e metodave të perzjerjes, krehjes dhe tjerrjes së fibrave të leshit si dhe paisje dhe impiante përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.



-
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, makineritë/impianetet dhe materialet e mëposhtme:

- Reparte të përzierjes, krehjes, fitilit, tjerrjes dhe drejdhjes së fibrave të leshit si dhe mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari;
 - Linjat e përzierjes, krehjes, krehjes së lartë, tjerrjes dhe dredhjes;
 - Lëndët e para si: fibra leshi;
 - Solucionet larëse, si dhe zbutësit e ndryshëm kimikë;
 - Lëndët e para dhe ndihmëse për realizimin e proceseve të ndryshme të përpunimit;
 - Karta teknologjike, manualë, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-



2. Moduli “Thurrjet e pulovrave”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Tekstil

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	THURRJET E PULOVRAVE	M-10-614-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të thurrur pulovra në makinat e trikotazhit e për ti qepur ato.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi përgatit llastiqet për mëngët dhe trupin e pulovrës. Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit të punës.- Përgatitja e makinerive dhe mjeteve të punës.- Vendosja e fillit në makinën e thurjes.- Thurrja e llastiqeve në makinat përkatëse.- Vendosja e llastiqeve në krehërat e tezgjahut.- Vijueshmëria e procesit të thurjes së llastiqeve- Eliminimi i defekteve gjatë thurjes së llastiqeve.- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin e punës;- të përgatisë makinat e trikotazhit dhe mjetet e punës për thurjen e llastiqeve të mëngëve dhe trupit të pulovrës;- të vendosë fillin nga bobina në makinën mekanike të thurjes së llastikut;- të thurë llastiqet në makinën përkatëse;- të vendosë llastiqet në krehërat e tezgjahut;- të mundësojë vijueshmërinë e procesit të thurjes së llastiqeve, duke kontrolluar lëvizjen e fillit në gjilpërat e



-
- makinave të thurjes;
 - të eliminojë defektet, duke kontrolluar këputjen e fillit dhe thyerjet e gjilpërave, gjatë procesit të thurjes së llastiqeve;
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

RM 2 Nxënësi thurr fytin e pulovrës në formë V-je dhe rrethore.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e makinerive dhe mjeteve të punës.
- Vendosja e fillit në makinën e thurjes së fytit.
- Vendosja e fillit ndarës së fytit në makinën e thurjes.
- Thurrja e fytit në makinën përkatëse.
- Eliminimi i defekteve gjatë thurjes së fyteve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës
- të përgatisë makineritë dhe mjetet e punës për thurjen e fyteve në forma të ndryshme sipas procedurave standarde.
- të vendosë fillin nga bobina në makinën e thurjes së fytit, sipas modelit dhe përmasave të përcaktuara.
- të vendosë fillin ndarës të fytit, në makinën e thurjes;
- të thurrë fytin, duke kontrolluar lëvizjen e fillit në gjilpërat e makinës së thurjes.
- të eliminojë defektet gjatë thurjes, duke kontrolluar këputjen e fillit dhe thyerjet e gjilpërave gjatë këtij procesi.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për thurjen fytin e pulovrës në formë V-je dhe rrethore.

RM 3 Nxënësi thurr pulovrën

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.



- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Vendosja e fillit në makinat e thurjes së katër pjesëve të pulovrës.
- Vendosja e krehërave me llastiqet përkatëse në krehërat e tezgjahut
- Vendosja e fillit në tezgjahet përkatëse sipas pjesëve të pulovrës.
- Thurja e pjesëve të pulovrës sipas modelit dhe përmasave të caktuara
- Eliminimi i defekteve gjatë thurjes së pulovrës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës
- të përgatisë mjetet e punës për thurjen e pjesëve të pulovrës sipas procedurave standarde.
- të vendosë fillin nga bobina në makinat e thurjes së katër pjesëve të pulovrës.
- të vendosë krehërat me llastiqet përkatës, në krehërat e tezgjahut me 16 dhe 12 koka.
- të vendosë fillin në tezgjahun përkatës, sipas pjesëve të pulovrës
- të thurë shpinën, përparësen dhe mëngët e pulovrës, duke kontrolluar lëvizjen e fillit në gjilpërat e makinave të thurjes.
- të eliminojë defektet, duke kontrolluar këputjen e fillit dhe thyerjet e gjilpërave gjatë procesit të thurjes.
- të pastrojë vendin e punës, duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për thurjen e pulovrës.

RM 4 Nxënësi qep pulovrën

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për qepjen e pulovrave;
- Prerja e harkut të qafës së shpinës së thurur.
- Prerja e harkut të qafës së përparëses së thurur.
- Prerja e kokës së mëngëve të thurura.
- Bashkimi i supeve të pulovrës.
- Bashkimi i fytit të thurur në harkun e qafës.
- Montimi i mëngëve në trupin e pulovrës.



- Mbyllja e pjesëve anësore të trupit të pulovrës.
- Pastrimi i pulovrës.
- Kontrolli i cilësisë së pulovrës.
- Etiketimi i pulovrës.
- Paketimi i pulovrës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e pulovrave.
- të presë harkun e qafës së shpinës së pulovrës nëpërmjet makinës syzator.
- të presë harkun e qafës përparësen në formë rrethore, apo V-je sipas modelit të pulovrës nëpërmjet makinës syzator.
- të presë kokat e mëngëve në makinën syzator sipas formës së duhur.
- të bashkojë me makinë supet e pulovrës, duke vendosur supet e shpinës poshtë supeve të përparëseve.
- të bashkojë fytin e thurur me harkun e qafës në formë V-je dhe rrethore.
- të montojë mëngët në harkun e gavaturave të pulovrës, duke bashkuar shpinën e mëngës me shpinën e trupit.
- të mbyllë pjesët anësore të trupit të pulovrës, duke bashkuar shpinën me përparësen;
- të pastrojë pulovrën e thurur nga penjtë.
- të kontrollojë cilësinë e thurjes dhe të qepjes së pulovrës në makinat ndriçuese.
- të vendosë etiketat në vendin e caktuar të pulovrës
- të paketojë pulovrën.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë qepjes së pulovrës.

RM 5 Nxënësi llogarit çmimin e pulovrës së prodhuar.

Përmbajtja:

- Përgatitja e preventivit të pulovrës.
- Përlllogaritja e kostos së pulovrës.
- Përlllogaritja e çmimit për lloje të ndryshme pulovrash.
- Plotësimi i faturës për klientin
- Komunikimi me etikë me klientin

Instrumentet e vlerësimit:



- Vëzhgim me listë kontrolli

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë preventivin e pulovrës;
- të përlllogarisë koston e pulovrës;
- të përlllogarisë çmimin për lloje të ndryshme pulovrash;
- të plotësojë faturën për klientin gjatë shitjes së pulovrës;
- të komunikojë me etikë me klientin.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të thurjes së trikotazheve, apo të thurjes së artikujve prej trikotazhi dhe rekomandohet të organizohen vizita njohëse ne ndermarrje të thurjes së trikotazhit.
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për thurjen e llastiqeve, fyteve dhe të pjesëve të pulovrës si me jakë rrethore, ashtu edhe me jakë në formë V-je.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për thurjen e llastiqeve, fyteve, shpinës, përparëses, mëngëve, prerjes së harkut të qafës sipas modelit të pulovrës dhe qepjen, kontrollin e cilësisë, etiketimin e paketimin e pulovrës.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi thurjen ellastiqeve, hyteve, shpinës, përparëses, mëngëve, prerjen e formës së qafës dhe të kokës së mëngës, qepjen e pulovrës, kontrollit të cilësisë, si dhe etiketimit dhe paketimit të pulovrës.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- repart trilotazhi;
- makineri të thurjes së llastiqeve, fyteve dhe tezfaj të thurjes së trupit dhe mëngëve me 12 dhe 16 koka;
- makinë syzator;
- makinë qepëse;
- tavolinë ndricuese;
- lëndë të para dhe ndihmëse për thurjen dhe qepjen e pulovrës;
- pankarta, makete, udhëzues, katalogë, etj.



3. Moduli “Përmbartimi dhe ngjyrimi i tekstileve sintetike”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Tekstil

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PËRMBARIMI DHE NGJYRIMI I TEKSTILEVE SINTETIKE	M-10-615-11
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të realizuar procesin e përmbartimit dhe të ngjyritimit të tekstileve sintetike sipas kërkesave të industrisë së konfeksioneve dhe tregut.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen proceset parapërgatitore të nevojshme për ngjyrimin e tekstileve sintetike. <i>Përmbajtja:</i> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit të punës.- Përgatitja e mjeteve të punës.- Veshja e uniformës së punës.- Interpretimi i kartave teknologjike të proceseve përgatitore për tekstilet sintetike;- Përcaktimi i parametrave të nevojshëm për operatione të caktuar për tekstilet sintetike;- Përgatitja e preparateve kimikë të nevojshme për proceset përgatitore;- Kontrolli i parametrave dhe gjendjes së pajisjeve/impianitit para fillimit të punës;- Zierja e tekstileve sintetike;- Zbardhja e tekstileve sintetike;- Tharja e tekstileve sintetike;- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë parapërgatitjes për ngjyrimin e tekstileve sintetike. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <i>Kriteret e vlerësimit:</i>	



Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të veshë uniformën e punës;
- të interpretojë kartat teknologjike të proceseve përgatitore për tekstilet sintetike;
- të përcaktojë parametrat e nevojshëm për operatione të caktuar për tekstilet sintetike
- të përgatis preparate kimikë të nevojshme për proceset përgatitore;
- të kontrollojë parametrat dhe gjendjen e pajisjeve/impianitit para fillimit të punës;
- të ziejë tekstilet duke respektuar parametrat e përcaktuar më parë;
- të zbardhë tekstilet sintetike sipas kërkesave të operationeve të linjës teknologjike në vazhdim;
- të thajë tekstilet sintetike, në varësi të destinacionit të produktit/gjysmëproduktit;
- të pastrojë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës në repartin e përpunimit paraprak të tekstileve sintetike.

RM 2 Nxënësi ngjyros tekstilet sintetike

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës
- Përzgjedhja e metodës së ngjyimit;
- Interpretimi i kartës teknologjike të ngjyimit të fillit sintetik;
- Interpretimi i kartës teknologjike të ngjyimit të tekstileve sintetike;
- Përgatitja e preparateve ngjyrues;
- Përcaktimi i parametrave të makinës/impianitit të ngjyimit;
- Ngjyrimi i fillit sintetik;
- Ngjyrimi i tekstileve sintetike;
- Kontrolli i vijueshmërisë së procesit të ngjyimit;
- Kontrolli i cilësisë së ngjyimit të tekstileve sintetik;
- Larja e tekstileve pas ngjyimit;
- Tharja e tekstileve pas ngjyimit;
- Analiza e treguesve teknik të ngjyrës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit



Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të veshë uniformën e punës;
- të përzgjedhë metodën e ngjyimit në varësi të llojit të produktit (fill ose pëlhurë);
- të interpretojë kartën teknologjike të ngjyimit të fillit sintetik;
- të interpretojë kartën teknologjike të ngjyimit të tekstileve sintetike;
- të përgatisë preparatet ngjyuese sipas kartës teknologjike;
- të përcaktojë parametrat e makinës/impianit të ngjyimit; sipas llojit të tekstilit
- të ngjyrosë fillin sintetik sipas të dhënave të kartës teknologjike
- të ngjyrosë tekstilet sintetike;
- të kontrollojë vijueshmërinë e procesit të ngjyimit duke mbajtur nën kontroll parametrat përkatës;
- të kontrollojë cilësinë e ngjyimit duke vëzhguar njëtrajtshmërinë e ngjyimit;
- të lajë tekstilet pas ngjyimit;
- të thajë tekstilet pas ngjyimit;
- të analizojë treguesit teknik të ngjyrës sipas kartës teknologjike;
- të pastrojë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës në repartin e ngjyimit të tekstileve sintetik.

RM 3 Nxënësi përmbaron tekstilet sintetike

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës
- Interpretimi i kartës teknologjike të linjës së apretimit;
- Përgatitja e solucioneve të apretimit;
- Realizimi i procesit të kalandrimit;
- Zgjerimi i tekstileve;
- Sanforizimi i tekstileve sintetike;
- Mercerizimi i tekstileve sintetike;
- Stampimi i tekstileve sintetike;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të



mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të veshë uniformën e punës;
- të interpretojë kartën teknologjike të linjës së apretimit;
- të përgatisë solucionet e apretimit, në varësi të tekstilit që do të përpunohet;
- të përgatisë solucionet e apretimit, në varësi të llojit të tekstilit dhe destinacionit të tij;
- të përcaktojë parametrat e makinës së e kalandrimit;
- të realizojë kalandrimin e tekstileve; në përputhje me kartën teknologjike përkatëse;
- të kryejë zgjerimin e tekstileve në përmasat e kërkuara;
- të kryejë sanforizimin e tekstileve sintetike; sipas standardeve të përcaktuara në kartën teknologjike;
- të bëjë mercerizimin e tekstileve sintetike sipas kërkesave specifike për produktin në fjalë;
- të stampojë tekstile sintetike, në përputhje e kartën teknologjike.
- të pastrojë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës në repartin e përmbarimit të tekstileve sintetike.

RM 4 Nxënësi bën vlerësimin e cilësisë, ambalazhimit; etiketimin dhe magazinimin e produkteve të gatshme.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Vlerësimi i cilësisë së fillit sintetik të ngjyrosur;
- Vlerësimi i pëlhurave sintetike të ngjyrosur/stampuar;
- Ambalazhimi i fillit sintetik të ngjyrosur;
- Ambalazhimi i pëlhurave sintetike të ngjyrosur/stampuar;
- Etiketimi i produkteve të gatshme;
- Magazinimi i produkteve të gatshme;
- Ruajtja e produkteve të gatshme;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.



Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të veshë uniformën e punës;
- të vlerësojë cilësinë e fillit sintetik të ngjyrosur; sipas standardeve të përcaktuara në manualin e cilësisë
- të vlerësojë cilësinë e pëlhurave sintetike të ngjyrosur/stampuar; sipas standardeve të përcaktuara në manualin e cilësisë
- të ambalazhojë fillin sintetik të ngjyrosur; në varësi të destinacionit
- të ambalazhojë bezen sintetike të ngjyrosur/stampuar; në varësi të destinacionit.
- të etiketojë produktet e gatshme; sipas standardeve të përcaktuara
- të magazinojë produktet e gatshme në kushte optimale;
- të ruajë produktet e gatshme në kushte optimale;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit, gjatë punës në repartin e përmbarimit dhe ambalazhimit të tekstileve sintetike.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune të fabrikave të ngjyrimit, apo mjedise të tjera të industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të teknikave të vlerësimit të cilësisë së produkteve të ngjyrosura ose stampuara dhe pajisjeve përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, makineritë/impianetet dhe materialet e mëposhtme:

- Fabrikë ngjyrimi e fillit dhe e pëlhurave ose mjedise të tjera të



industrisë tekstile që kryejnë këtë veprimtari.

- Linjat e ngjyritit të fillit dhe pëlhurave.
 - Lëndët e para si filli dhe bezja.
 - Ngjyruarit e nevojshëm për realizimin e ngjyrave të kërkuara;
 - Lëndët e para dhe ndihmëse për realizimin e proceseve të ndryshme të përpunimit.
 - Mjediset e magazinimit dhe ruajtjes në kushte optimale të produkteve përfundimtare.
 - Karta teknologjike, manualë, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-



4. Moduli “Prodhimi i tekstilit oksford”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Tekstil

Niveli: II

Klasa: 12

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PRODHIMI I TEKSTILIT OKSFORD	M-10-616-11
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të realizuar procesin e prodhimit të tekstilit oksford.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi kryen proceset e ngjyritit të fillit bazë në repartin e ngjyritit për tekstilin oksford. <i>Përmbajtja:</i> <ul style="list-style-type: none">- Përgatitja e vendit të punës.- Përgatitja e mjeteve të punës.- Veshja e uniformës së punës.- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të nevojshme.- Interpretimi i kartës teknologjike.- Marrja e bobinave me fill bazë.- Mbushja e aparatit të ngjyritit me bobina.- Përgatitja e ngjyruësve kubik.- Përgatitja e kimikateve ndihmëse.- Mbushja e aparatit të ngjyritit me përzierësit ngjyruës.- Regjistrimi i parametrave të makinerisë.- Kontrolli i enëve nën presion.- Ngjyrimi i bobinave në makinën e ngjyritit.- Nxjerrja e boshteve me bobina nga makina ngjyruëse.- Tharja e bobinave të ngjyrosura.- Depozitimi i bobinave të ngjyrosura.- Pastrimi i vendit të punës.- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p>	



-
- të përgatisë vendin e punës.
 - të përgatisë mjetet e punës.
 - të veshë uniformën e punës.
 - të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme
 - të interpretojë kartën teknologjike të proceseve përgatitore për ngjyrimin e fillit bazë;
 - të marrë bobinat me fill bazë nga depoja e fillit.
 - të mbushë aparatën e ngjyimit me bobina, tek boshtet me vrima.
 - të përgatisë ngjyruerit kubikë sipas kartës teknologjike.
 - të përgatisë kimikatet ndihmëse, sipas kartës teknologjike.
 - të mbushë makinerinë me ngjyruerit kubik dhe kimikatet ndihmëse.
 - të rregjistrojë parametrat e makinerisë.
 - të kontrollojë enën nën presion, për të eliminuar ndonjë shpërthim të kapakut të kazanit;
 - të ngjyrosë bobinat në makinën e ngjyimit, sipas kërkesave të kartës teknologjike.
 - të nxjerrë boshtet me bobina, nga makina ngjyruese.
 - të thajë bobinat e ngjyrosura, duke i vendosur në aparatet tharëse.
 - të depozitojë bobinat e ngjyrosura në depot e bobinave.
 - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për ngjyrosjen e fillit bazë në repartin e ngjyimit të tekstilit oksford.

RM 2 Nxënësi realizon procesin e mbledhjes së fillit bazë në makinat e mbledhjes, për tekstilin oksford.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse.
- Interpretimi i kartës teknologjike.
- Transportimi i fillit bazë në repartin e mbledhjes.
- Furnizimi i makinave të mbledhjes në fill.
- Regjistrimi i makinave të mbledhjes së fillit.
- Mbledhja e fillit bazë.
- Rregjistrimi i mekanizmit të fillit.
- Kontrolli i shpërndarjes së rregullt të fillit.
- Kontrolli i dendësisë së fillit të mbledhur.
- Kontrolli i tërheqjes së fillit.
- Kontrolli i formës së balonit të fijos.
- Pastrimi i aparatit kontrollues pastrues.



- Eliminimi i mbetjeve teknologjike.
- Depozitimi i fillit bazë.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të për zgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme
- të interpretojë kartën teknologjike të procesit të mbledhjes së fillit bazë;
- të transportojë fillin bazë në repartin e mbledhjes së fillit.
- të furnizojë makinat e mbledhjes me fill bazë;
- të rregjistrojë parametrat e makinës së mbledhjes së fillit, sipas kartës teknologjike;
- të mbledhë fillin bazë në bobina konike.
- të rregjistrojë mekanizmin e shpërndarjes së fillit në makinat e mbledhjes së fillit;
- të kontrollojë shpërndarjen e rregullt të fillit në bobina, me vëzhgim të herëpashershëm
- të kontrollojë cilësinë e dendësisë së fillit të mbledhur.
- të kontrollojë tërheqjen e fillit në aparatit e tërheqjes, duke mbajtur në rregjistrin e duhur
- të kontrollojë saktësinë e formës së balonit të fijos.
- të pastrojë aparatit kontrollues pastrues.
- të eliminojë mbetjet teknologjike nga makina e mbledhjes së fillit, duke zbatuar parametrat teknologjikë;
- të depozitojë fillin bazë në depon e endjes.
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë mbledhjes së fillit baze për tekstilin oksford

RM 3 Nxënësi realizon endjen e fillit bazë në makinën e endjes me shirita për tekstilin oksford.

Përmbajtja:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të nevojshme



- Interpretimi i kartës teknologjike.
- Furnizimi i makinës me fill bazë;
- Regjitrtrimi i parametrave të makinës;
- Ndarja e sasisë së bobinave.
- Mbushja e kafazit të endjes;
- Përshkrimi i fijeve bazë në aparatit tërheqës
- Regjistrimi i sinjalizuesve të ndalimit elektrik;
- Përshkrimi i fijeve në dhëmbët e krehërit;
- Llogaritja e sasisë së fijeve në një shirit të endjes;
- Tërheqja uniforme e të gjitha fijeve bazë.
- Kontrolli i dendësisë së fijeve në shirit;
- Endja e sasisë së plotë të fijeve baze;
- Mbushja e boshtit të tezgjahut
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të për zgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme
- të interpretojë kartën teknologjike të procesit të endje së fillit bazë
- të furnizojë makinën me fill baze;
- të rregjistrojë parametrat e makinës, sipas kartës teknologjike;
- të ndajë sasinë e bobinave, sipas raportit të ngjyrave;
- të mbushë kafazin e endjes me fill bazë;
- të përshkojë fijet bazë në aparatit tërheqës;
- të rregjistrojë sinjalizuesit e ndalimit elektrik të makinës së endjes;
- të përshkojë fijet bazë në dhëmbët e krehërit;
- të llogarisë sasinë e fijeve në një shirit të endjes;
- të tërheqë në mënyrë uniforme të gjitha fijet bazë;
- të kontrollojë dendësinë e njejte të fijeve përgjatë shiritit;
- të endë sasinë e plotë të fijeve bazë, sipas kartës teknologjike;
- të mbushë boshtin e tezgjahut me fijet bazë të marra nga tamburi i endjes;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare .
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për endjen e fillit bazë në makinën e



endjes me shirita, për tekstilin oksford

RM 4 Nxënësi kryen procesin e kollaritjes së fijeve bazë për tekstilin oksford.

Përmbajta:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të nevojshme.
- Interpretimi i kartës teknologjike
- Rregjistrimi i parametrave të makinës së kollaritjes.
- Furnizimi i makinës së kollaritjes.
- Përshkrimi i fijeve bazë.
- Përgatitja e kollit;
- Kontrolli i cilësisë së kollit;
- Kontrolli i cilësisë së solucionit ngjitës;
- Mbushja e vaskave të makinës;
- Kollaritja e fijeve bazë;
- Tharja e fijeve bazë të kollaritura.
- Kontrolli i cilësisë së fijeve të kollaritura.
- Mbushja e boshtit të tezgjahut.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme;
- të interpretojë kartën teknologjike të kollaritjes së fijeve bazë;
- të rregjistrojë parametrat e makinës së kollaritjes, sipas kartës teknologjike;
- të furnizojë makinën e kollaritjes me boshtin e bazës;
- të përshkojë fijet bazë në të gjithë gjatësinë e makinës së kollaritjes.
- të përgatisë solucionin e kollit për tekstilin oksfordt;
- të kontrollojë cilësinë e kollit, sipas kartës teknologjike;
- të kontrollojë cilësinë e solucionit ngjitës, sipas kartës teknologjike;
- të mbushë vaskat e makinës me solucionin e kollit;
- të kollarisë fijet bazë;



- të thajë fijet bazë të kollaritura në dhomat tharëse
- të kontrollojë cilësinë e fijeve të kollaritura, sipas kartës teknologjike;
- të mbushë boshtin e tezgjahut me fijet bazë;
- të pastrojë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për kollaritjen e fijeve bazë për tekstilin oksford.

RM 5 Nxënësi kryen procesin e përshkimit të fijeve bazë për tekstilin oksford

Përmbajta:

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të nevojshme.
- Interpretimi i kartës teknologjike.
- Përcaktimi i lamelave.
- Përcaktimi i sasisë së kuadrateve me lisa
- Përzgjedhja e krehërit.
- Përshkimi i fijeve bazë në lamela;
- Përshkimi i fijeve bazë në lisa.
- Kalimi i fijeve bazë në krehër;
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme;
- të interpretojë kartën teknologjike për përshkrimin e fijeve bazë;
- të përcaktojë lamelat, sipas numërave përkatës së fijeve;
- të përcaktojë sasinë e kuadrateve me lisa, sipas kartës teknologjike;
- të përzgjedhë krehërin, sipas numërit të kërkuar në kartën teknologjike;
- të përshkojë fijet bazë në lamela;
- të përshkojë fijet bazë në lisa, sipas radhës;
- të përshkojë fijet bazë në krehër, sipas llojit të thurrjes;



- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjiëno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për përshkrimin e fijeve bazë për tekstilin oksford.

RM 6 Nxënësi thur tekstilin oksford në makinat e tezgjahut

Përmbajta

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mjeteve të punës.
- Veshja e uniformës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve ndihmëse të nevojshme.
- Interpretimi i kartës teknologjike.
- Furnizimi i repartit të tezgjahut me boshte.
- Vendosja e boshtit me fill në makinën e tezgjahut;
- Shtirirja e fijeve bazë në gjatësinë e makinës;
- Mbushja e tavolinës së makinës së tezgjahut me masura me fill ind.
- Vendosja e masurave me fill me mecik.
- Vendosja e mecikëve në kutite e makinës së tezgjahut;
- Vendosja e raportit për ngjyrat;
- Vendosja e kordonit të kuadratave
- Vendosja në punë e makinerisë së tezgjahut.
- Kontrolli i raportit të ngjyrave të fillit bazë;
- Kontrolli i raportit të ngjyrave të fillit ind;
- Furnizimi i vashdueshëm i makinerisë me fill ind;
- Eliminim i këputjeve të fillit bazë;
- Kontrolli i cilësisë së tekstilit të prodhuar;
- Magazinmi i tekstilit të prodhuar.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisi.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës.
- të përgatisë mjetet e punës.
- të veshë uniformën e punës.
- të përzgjedhë materialet ndihmëse të nevojshme;
- të interpretojë kartën teknologjike për thurjen e tekstilit oksford në makinën e tezgjahut
- të furnizojë repartin e tezgjahut me boshtet me fill bazë;
- të vendosë boshtin me fill bazë në makinën e tezgjahut;



- të shtrijë fillin bazë në gjatësinë e makinës;
- të mbushë tavolinën e makinës së tezgjahut me fill ind, sipas ngjyrave;
- të vendosë masuarat me fill në meçik;
- të vendosë mecikët me fill, në kutitë e makinës së tezgjahut, sipas raportit të ngjyrave;
- të vendosë raportin me pllaka për ngjyrat, sipas kartës teknologjike;
- të vendosë kordonin e kuadratave në kokën e karetkës;
- të verë në punë makinerinë e tezgjahut;
- të kontrollojë saktësinë e raportit të ngjyrave të fillit bazë, sipas kartës teknologjike;
- të kontrollojë saktësinë e raportit të ngjyrave të fillit ind sipas kartës teknologjike;
- të furnizojë në mënyrë të vazhdueshme makinën e tezgjahut me fill ind;
- të eliminojë këputjet e filli bazë gjatë punës;
- të kontrollojë cilësinë e tekstilit oksford të prodhuar, sipas parametrave teknologjikë të kërkuar;
- të magazinojë tekstilin e prodhuar nga fabrika e tezgjahut në magazinë, në kushte optimale ruajtje;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për thurjen e tekstilit oksford ne makinat e tezgjahut.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise reale pune në repartet e fabrikës së tezgjahut me fill të ngjyrosur.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të teknikave të vlerësimit të cilësisë së produkteve të pëlhurave të prodhuara dhe pajisjeve përkatëse.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me veprimtaritë që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e detyrave të dhëna.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.



**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, makineritë/impianetet dhe materialet e mëposhtme:

- Reparti i ngjyrosjes së fillit bazë;
 - Reparti i mbledhjes së fillit bazë dhe ind,
 - Reparti i endjes me shirita të fillit bazë;
 - Reparti i kollaritjes së fillit bazë,
 - Reparti i përshkimit të fillit bazë;
 - Reparti i thurjes së tekstilit oksford,
 - Lëndët e para si filli bazë dhe ind;
 - Kartat teknologjike për prodhimin e pëlhurave;
 - Mjediset e magazinimit dhe ruajtjes në kushte optimale të produkteve përfundimtare;
 - Karta teknologjike, manualë, udhëzues dhe materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-